



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

02 Nr. 111-23530/25

Klinë, më 09.08.2025

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 44 dhe nenit 53, paragrafin 1, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, si dhe Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me A.nr.783/2025, të dt. 16.07.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, merr :

VENDIM

Për anulimin e konkursit me RN00016714/RPC0010253

I. ANULOHET konkursi me numër të referencës RN00016714/ RPC0010253, Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore” në Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim Rural, në Komunën e Klinës, i shpallur me dt. 13.02.2025, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.07.2025, ka nxjerr vendimin me A.nr.783/2025, nëpërmjet të cilit e ka anuluar konkursin me numër të referencës RN00016714/ RPC0010253, Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “ Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore” në Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Klinës, i shpallur me dt. 13.02.2025 dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, si dhe e ka obliguar kryetarin e Komunës dhe Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të vendimit me A.nr.783/2025, të dt.16.07.2025, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartpërmendurat Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejt të ushtroj ankesë, pran Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me seli në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të tij.

Kopja i dërgohet:

- KPMSHCK-së;
- Kandidateve;
- Arkivit;



Menaxheri i Burimeve Njerëzore

Shayir Dauti